

VENDIM
Nr. 622, datë 30.7.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I RRUGËS ELBASAN – QAFËTHANË (FAZA I)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan–Qafëthanë (faza I)”.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 278 400 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 278 400 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.
8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
10. Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, e cila brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuara sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “ZGJERIM I RRUGËS ELBASAN–QAFËTHANË (FAZA I)”

	Pronari				Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)						Vlerësimet për shpronësim							Vlera totale	Shënime (seksioni C, D, E, i kartelës së pasurisë)	Adresat e pronarëve		
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Adresa e pasurisë	Zona kadastral e	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaq ja totale	“Arë ” (m ²)	“Ndërtesë” (m ²)	Sipërfaqja (m ²)	Cmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Cmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m ²)				Cmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)
1	Ali	Rrapush	Murati	Mirakë	2696	488	Arë	1248			14	174	2,436.00							2,436	Rr. “Mirake”, Gjovac	
2	Beqir	Rrapush	Murati	Mirakë	2696	499/1	Arë	3480			383	174	66,642.00							66,642	Rr. “Mirake”, Gjovac	
3	Feride	Idriz	Krozi	Mirakë	2696	508	Arë	1467			226	174	39,324.00							39,324	Rr. Kocit	
	Hasan	Sherif	Krozi	Mirakë																		
	Myzejene	Sherif	Koçi	Mirakë																		
	Qamile	Nezir	Krozi	Mirakë																		
	Irjan	Hasan	Krozi	Mirakë																		
	Drilona	Hasan	Krozi	Mirakë																		
4	Xhafer	Ali	Krozi	Mirakë	2696	512	Arë	1454			283	174	49,242.00						49,242	Rr. Kocit		
5	Mustafa	Ali	Krozi	Mirakë	2696	518	Arë	1000			140	174	24,360.00						24,360	Mirake		
6	Dritan	Idriz	Krozi	Mirakë	2696	524	Arë	895			123	174	21,402.00							21,402	Mirake	
	Xhemile	Selman	Krozi	Mirakë																		
	Andelina	Idriz	Hoxha	Mirakë																		
	Fatime	Idriz	Zeneli	Mirakë																		
	Gentjan	Idriz	Krozi	Mirakë																		
7	Ramazan	Ismail	Terziu	Mirakë	2696	536	Arë+truall	1585			208	174	36,192.00						36,192	Mirake		
8	Musa	Ismail	Terziu	Mirakë	2696	539	Arë+truall	1090			104	174	18,096.00							18,096	Rr. “Inajete Dume”	
	Irena	Nevrus	Terziu	Mirakë																		
9	Qamile	Ali	Terziu	Mirakë	2696	548	Arë	883			119	174	20,706.00							20,706	Rr. Shkollës	
	Hajri	Ibrahim	Terziu	Mirakë																		
	Jetmir	Ibrahim	Terziu	Mirakë																		
	Hamit	Ibrahim	Terziu	Mirakë																		
	Erjon	Ibrahim	Terziu	Mirakë																		
	Xhevahir e	Ibrahim	Cani	Mirakë																		
VLERA TOTALE																				278,400		